

*Shefkije Islamaj  
Nexhmije Thaçi – Mehmetaj*

● ●  
**Për nivelin  
e dytë**

# **GJUHA SHQIPE**



EMRI DHE MBIEMRI \_\_\_\_\_  
KLASA \_\_\_\_\_  
SHKOLLA \_\_\_\_\_  
VENDI \_\_\_\_\_  
SHTETI \_\_\_\_\_



Këtë libër e gjeni edhe në versionin elektronik dhe mund ta shkarkoni nga uebfaqja e MASHT të Kosovës <http://www.mash-t.gov.net>



Shefkije Islamaj, Nexhmije Thaçi–Mehmetaj

# GJUHA SHQIPE

Fletore tematike  
për nivelin e dytë

*duk<sup>a</sup>gjini*

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS  
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE  
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,  
Nexhmije Thaçi-Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj,  
Xhevat Sylja.

Hartues/e të këtij teksti: Shefkije Islamaj, Nexhmije Thaçi-Mehmetaj

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut  
(Instituti IPE – International Projects in Education) dhe  
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.

**PH Zürich** 

**LOTTERIEFONDS  
KANTON ZÜRICH**

## PËRMBAJTJA

FJALA DHE PËRBËRËSIT E SAJ .....	4
EMRI .....	7
Gjinia e emrave .....	10
Trajta e pashquar dhe e shquar e emrave .....	11
Formimi i numrit shumës tek emrat .....	12
Lakimi i emrave .....	15
DREJTSHKRIM .....	17
Përdorimi i shkronjës së madhe .....	17
MBIEMRI .....	18
Shkallët e mbiemrit .....	21
PËREMRI .....	23
Përemrat vetorë .....	23
Përemrat dëftorë .....	25
Përemrat pronorë .....	26
Përemrat pyetës .....	28
DREJTSHKRIM .....	30
Përdorimi i apostrofit .....	30
FOLJA .....	31
Foljet <b>jam</b> dhe <b>kam</b> .....	34
NDAJFOLJA .....	36
PARAFJALA .....	39
LIDHËZA .....	41
FJALIA .....	43
Fjalja e thjeshtë dhe fjalia e thjeshtë e zgjeruar .....	44
Llojet e fjalisë .....	45
KRYEFJALA .....	48
KALLËZUESI .....	50
RRETHANORI .....	52
NJOHURI PËR GJUHËN SHQIPE .....	56
Shqipja - gjuhë indoevropiane .....	57
Dokumentet e para shkrimore të gjuhës shqipe .....	58
Dialektet e gjuhës shqipe .....	60
Gjuha standarde shqipe .....	63

## FJALA DHE PËRBËRËSIT E SAJ

Mbani në mend!

Fjala është njësia kryesore e një gjuhe. Ajo ka **formë** dhe **kuptim**.

Fjala **qytet** = formë + kuptim

**Forma:** tingujt (shkronjat): **q y t e t**

**Kuptimi:** vendbanim me shumë ndërtesa, rrugë, ente shkollore, spitale etj.

Lexoni me vëmendje!

Ari bleu një **top**.

Ajo është **vajzë** e urtë.

Unë e **hap** derën.

Ajo ma ktheu **topin**.

Dje pashë **vajzën** e tij.

Ato e **hapën** derën.

Këta janë **topat** e mi.

**Vajza** thirri me zë të lartë.

Dera **hapet**.

Çka keni vërejtur?

Fjala **top** në këto tri fjali paraqitet me tri forma të ndryshme: **top**, **topin**, **topat**.

Fjala **vajzë** në këto tri fjali paraqitet me tri forma të ndryshme: **vajzë**, **vajzën**, **vajza**.

Fjala **hap** në këto tri fjali paraqitet me tri forma të ndryshme: **hap**, **hapën**, **hapet**.

Mbani në mend!

Fjala gjatë përdorimit merr forma të ndryshme,  
por ndryshon vetëm një pjesë e fjalës.

Përbërësit e fjalës janë: **rrënja** **mbaresa** **parashtesa** **prapashtesa**

Pjesa e fjalës që nuk mund të ndahet në pjesë përbërëse dhe që përmban kuptimin kryesor quhet **rrënjë** e fjalës: **top**, **vajzë**, **hap**.

Pjesa e ndryshueshme e fjalës quhet **mbarësë** e fjalës: **-in**, **-at**; **-ën**, **-a**, **-en**. Këto mbaresa tek emrat dhe mbiemrat tregojnë gjininë, numrin a rasën, te foljet vetën, kohën etj.

### Bisedojmë!

Te fjala **qyteti** rrënjën e gjejmë duke i hequr asaj mbaresën **-i**. Kështu na del rrënja **qytet**. Kësaj fjale mund t'i shtojmë mbaresa të tjera dhe të fitojmë format: **qytetin, qytetit, qyteteve, qytete, qytetet, qyteteve**. Por kësaj fjale mund t'i shtojmë edhe prapashtesën **-ar** dhe të fitojmë fjalën **qytetar**.

### Ushtrojmë!

Lexo fjalitë dhe analizo fjalën duke dalluar rrënjën, mbaresat, parashtesat dhe prapashtesat e saj.

**Puna** ka kalitur njeriun. Ari është **punëtor** i mirë. Ai **punon** në shkollë.  
Ne vizituam **punishten**. Axha Shpend ka **punëtorinë** e tij.  
Ai punon në fabrikën për **përpunimin** e mishit. Duhet ta **ripunosh** detyrën!

### Mbani në mend!

Prej fjalëve rrënjë formohen fjalë të reja përmes të cilave pasurohet gjuha.  
Fjalët që kanë rrënjë të përbashkët, formojnë një familje fjalësh

Të shohim si duken në tabelë fjalët që kanë të njëjtën rrënjë - **punë**.

fjala	parashtesa	rrënja	prapashtesa	mbaresa
punë	-	punë	-	
punëtor	-	punë	tor	
punim	-	pun(ë)	im	
punues	-	pun(ë)	ues	
punishte	-	pun(ë)	ishte	
përpunoj	për	pun(ë)	o	j
ripunim	ri	pun(ë)	im	

Fjalës rrënjë mund t'i shtohen shtesa përpara (**parashtesa**) dhe prapa (**prapashtesa**) dhe kështu formohen fjalë me kuptime të reja.

Fjalë e përbërë quhet fjala e formuar nga bashkimi i dy ose më shumë temave në një fjalë të vetme. P.sh. **breg+det** (bregdet), **orë+ndreqës** (orëndreqës), **rroba+qepës** (rrobaqepës).

### Detyrë

Ndërto fjalë me kuptime të reja me ndihmën e parashtesave: **për-, ri -, zh-** dhe kopjo fjalët drejt:

për	hap	ri	lindje	zh	dukem
	kthej		ndërtim		bëj
	gjysmoj		këndim		vishem
	krah		kujtim		vendos

Ndërto fjalë me ndihmën e prapashtesave:

-sor	-ësi	-tar	-tor	-tari
anë.....	shëndet.....	arsim.....	ditë.....	treg .....
mal(ë).....	fshatar.....	udhë.....	punë.....	pemë .....
këmbë.....	miq.....	besë .....	faj.....	kopsht .....

Ndërto fjalë të përbëra me ndihmën e fjalëve **emër +emër, emër + mbiemër etj.:**

zemër-	sy-	dorë-	flokë-
..... bardhë	..... shkruar	..... lirë	.....drejt
..... mirë	..... petrit	..... lehtë	.....shkurtër
..... lepur	..... zi	..... mbarë	.....kaçurrela
..... luan	..... mbyllur	..... thatë	..... gjatë

### Detyrë:

**Shkruaj rrënjën e përbashkët të fjalëve në shembujt e mëposhtëm:**

zemër	zemërim	zemëroj	përzemërsi	përzemërsisht	zemërdëlirë
-------	---------	---------	------------	---------------	-------------

vend	vendos	vendkalim	vendbanim	zhvendosje	vendlindje
------	--------	-----------	-----------	------------	------------

**Qarko me ngjyrë të kuqe rrënjën e këtyre dy grupeve të fjalëve:**

ujë	ujësjellës	ujëra	ujitje	ujëpritës	ujëvarë
-----	------------	-------	--------	-----------	---------

orë	orëmirë	orëshitës	orëtari	orëndreqës	orëkeq
-----	---------	-----------	---------	------------	--------

### Detyrë:

**Krahasoji gjuhët!** Kemi mësuar që në gjuhën shqipe fjalët përbëhen nga rrënja, mbaresa, parashtesa, prapashtesa. Si është puna në gjuhën e vendit ku jeton?



- A mund të tregosh një apo disa shembuj për rrënja dhe mbaresa?
- A mund të tregosh shembuj për parashtesa dhe prapashtesa?
- A mund të tregosh shembuj për fjalë të përbëra (si kryeqytet)?
- A ekzistojnë familje fjalësh (si në shqip, p.sh. punë - punëtor - punoj - punishte etj.)?

## EMRI

Mbani në mend!

Fjala që emërton një frymor, një send, një cilësi, një veprim quhet **emër**.

Shëno nën ilustrim emrat e duhur!



Fjalët që tregojnë frymorë e sende quhen **emra konkretë**, p.sh.: **njeri, flutur, plak, qengj, laps, djep, mollë** etj.

Fjalët që tregojnë cilësi e veprime quhen **emra abstraktë**: **bukuri, mençuri, mësim, lojë, lëvizje, gatim, ëndërr** etj.

Emri ka tri gjini:

<b>mashkullore</b>	<b>burrë, rosak, luan, gur, vrapim, fshat, qiell, shok, qytet, sukses</b> etj.
<b>femërore:</b>	<b>grua, pulë, shqiponjë, hënë, fushë, bankë, trimëri, foshnjë, dhembje</b> etj.
<b>asnjanëse</b>	<b>të menduarit, të ecurit, të mësuarit, të uruarit</b> etj.






Emri mund të përdoret në numrin **njëjës** dhe numrin **shumës**.




Emri në numrin **njëjës** tregon *një* frymor, *një* send, *një* cilësi, *një* veprim etj.


		
një vajzë	një rosakë	një karotë

Emri në **numrin shumës** tregon *dy a më shumë* frymorë, sende, cilësi, veprime etj.

		
disa vajza	disa rosa	disa karota

Emri mund të jetë i **përveçëm** ose i **përgjithshëm**.

		
Zana	Murro	Kosova



**Emri i përveçëm** emërton një njeri, një kafshë, një qytet, një lumë, një det ose diçka të dalluar nga të tjerët.

**Emri i përgjithshëm** emërton frymorë ose sende jo të veçanta.

## Mbani në mend!

Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë e parë të madhe, p.sh. *Zana, Drini, Kosova, Evropa, Murro, Kosova* etj., kurse emrat e përgjithshëm me shkronjë të vogël, p.sh.: *laps, zog, qytet, mollë, fëmijë, libër* etj..

## Detyrë

### 1. Lexo tekstin në vijim duke i shënuar në tabelë emrat e përveçëm dhe emrat e përgjithshëm.

**Rina** e **Leka** bënë gati valixhet. Ata bashkë me prindërit do të shkojnë për pushime në Shqipëri. Me vete do ta marrin edhe qenin Riki. Atyre u pëlqejnë shumë plazhet e detit Adriatik. Sivjet nuk do të ndalen në një vend. Do të nisin pushimet në Shën Gjini e do të zbresin teposhtë duke u ndalur në plazhet e Durrësit, Semanit, Vlorës e deri në Dhërmi. Bukuria e plazheve shqiptare është e mahnitshme.

Para se të kthehen në Zvicër ata do të shkojnë përmes tunelit të Kalimashit edhe në Kosovë. Malli për vendlindjen e prindërve, për gjyshërit e për ushqimet që gatuan gjyshja Dritë është i papërbalueshëm.

Do të jetë një pushim për t'u mbajtur në mend gjatë.

Emra të përveçëm	Emra të përgjithshëm	Emra konkretë	Emra abstraktë

## Gjinia e emrave

### Mbani në mend!

Emrat që marrin në fund - **i** ose - **u** ( si p.sh. *djali*, *mësuesi*, *shoku*, *miku*) janë emra të gjinisë mashkullore.

Emrat që marrin në fund - **a** dhe - **ja** ( si p.sh. *vajza*, *nëna*, *mësuesja*, *nxënësja*) janë emra të gjinisë femërore. Shumica e emrave të gjinisë femërore shkruhen me - **ë** në fund sikur në shembujt *rrugë*, *shkollë*, *klasë*, *çantë*, *borë*, *gazetë*, *punë*, *plakë*, *nënë*, *vajzë* etj.

### Detyrë

#### 1. Plotësoni fjalitë me emrat që kërkohen!



- a) \_\_\_\_\_ e Arit është pranë shkollës.
- b) \_\_\_\_\_ është mbushur plot me yje.
- c) \_\_\_\_\_ i Lirës është me ngjyrë të gjelbër.

2. Në tabelën e majtë shëno emrat e gjinisë **mashkullore**, ndërsa në të djathtën emrat e gjinisë **femërore**: **macja**, **elefanti**, **goja**, **Fitorja**, **bregu**, **nipi**, **hunda**, **Rinori**, **nxënësja**, **gjuri**.

Emrat e gjinisë mashkullore

Emrat e gjinisë femërore

## Trajta e pashquar dhe trajta e shquar e emrave

Mbani në mend!

Emrat kanë dy trajta: trajtën e pashquar (nxënës, mjek, goma) dhe trajtën e shquar (nxënësi, mjeku, goma)

Në trajtën e shquar njëjës emrat marrin në fund këto tri zanore: **-i, -u, -a**

Në trajtën e shquar shumës emrat marrin në fund **-t** ose **-të** ( qytetarë**-t**, miq**-të**)



nxënës / nxënësi



mjek / mjeku



gomë / goma

### Trajta e shquar e emrave femërorë

Kosovë – Kosov**a**

liri – liri**a**

porosi – porosi**a**

çati – çati**a**

gotë – got**a**

kokë – koka**a**

lugë - luga**a**

pjatë - pjat**a**

lajthi – lajthi**a**

### Lexoni dhe vëreni me kujdes emrat e mësipërm!

Me se mbarojnë ata në trajtën e pashquar? Po në trajtën e shquar?

Në ç'gjini janë?

Provoni të mbani mend disa nga këta emra dhe i shkruani në fletore në trajtën e shquar.

### Trajta e shquar e emrave mashkullorë

Agron – Agron**i**

mësim – mësim**i**

njeri - njeri**u**

mal – mali**i**

shok – shok**u**

tren - tren**i**

pirun – pirun**i**

ujk - ujk**u**

zog - zog**u**

### Lexoni dhe vëreni me kujdes emrat e mësipërm!

Me se mbarojnë ata në trajtën e pashquar? Po në trajtën e shquar?

Në ç'gjini janë?

Provoni të mbani mend disa nga këta emra dhe i shkruani në fletore në trajtën e shquar.

## Detyrë

Emrat e mëposhtëm shkruaji në dy shtyllat përkatëse të tabelës sipas gjinisë e trajtës:  
orë, pyll, nënë, ari, shok, çantë, krah, vajzë, djalë, hënë, aeroplan

Emra të gjinisë mashkullore		Emra të gjinisë femërore	
Trajta e pashquar	Trajta e shquar	Trajta e pashquar	Trajta e shquar

## Formimi i numrit shumës tek emrat

Mbani në mend!





Emrat e gjuhës shqipe e formojnë shumësin në njërën nga këto katër mënyra kryesore:

1. Me mbaresa të ndryshme		2. Me ndryshime fonetike	
( një ) qytet	(shumë) qytet <b>e</b>	(një) zog	(shumë) zog <b>j</b>
(një) tregim	(shumë) tregim <b>e</b>	(një) dorë	(shumë) duar <b>r</b>
( një ) laps	(shumë) laps <b>a</b>	(një) derë	(shumë) dyer <b>r</b>
(një) fshat	(shumë) fshat <b>ra</b>	(një) plak	(shumë) pleq <b>q</b>
(një) shkumës	(shumë) shkumës <b>a</b>	(një) djalë	(shumë) dj <b>em</b>
(një) vajzë	(shumë) vajz <b>a</b>	(një) kalë	(shumë) kuaj <b>j</b>

3. me mbaresa dhe me ndryshime fonetike		4. pa ndryshim të trajtës së njëjësit	
( një ) pyll	( shumë ) pyj <b>e</b>	( një ) nxënës	( shumë ) nxënës
( një ) lumë	( shumë ) lumen <b>j</b>	( një ) mësues	( shumë ) mësues
( një ) portokall	( shumë ) portoka <b>j</b>	( një ) mësuese	( shumë ) mësuese
( një ) kungull	( shumë ) kungu <b>j</b>	( një ) fletore	( shumë ) fletore
( një ) gjarpër	( shumë ) gjarpër <b>in</b> j	( një ) lule	( shumë ) lule
( një ) oxhak	( shumë ) oxha <b>q</b> e	( një ) mollë	( shumë ) mollë

### Detyra

1. Vendosni nga një emër poshtë çdo figure! Kthejini emrat në numrin shumës!

2.) Formoni nga një fjali me emrat që gjetët në ushtrimin nr. 1, duke i përdorur në numrin njëjës dhe shumës!

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

3.) Formoni nga një fjali me emrat që mund të gjeni tek ushtrimi nr.1, duke i përdorur në numrin njëjës dhe shumës!


a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

ç) \_\_\_\_\_

4. Vendosni nga një emër nën çdo figurë duke i kthyer në shumës!



5.) Ktheji në numrin shumës emrat: kalë, murator, urë, fletore, javë, shtëpi, kopshtar, lopatë, çantë, duke u vënë përpara fjalën shumë ose disa!

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

6.) Ktheji në numrin njëjës emrat: shkollat, fëmijët, lulet, burrat, gratë, dyert, vendet duke u vënë përpara fjalën një!

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

7.) Si formohen numrat njëjës dhe shumës në gjuhën e vendit ku jeton? Shëno ca shembuj:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## Lakimi i emrave

A e dini se:

Emri ndryshon kur lidhet me fjalë të tjera në fjali (p.sh. Ja një **top!** Merre **topin!**). Ndryshimi që pëson emri kur përdoret në fjali quhet **lakim**. Format e ndryshme që merr emri në fjali quhen **rasa**.

Lexo këto fjali me kujdes!

1. **Shoku** im recitoi bukur.
2. Recitimi **i shokut** më pëlqeu.
3. Librin e gjuhës ia dhashë **shokut**.
4. **Shokun** e klasës e takova në tren.
5. E mora fletoren **prej shokut**.

- Çka keni vërejtur? Çka ka ndodhur me fjalën **shok**?

Emri **shok** ka ndërruar formën disa herë.

Lakimi në gjuhën shqipe ka **5 rasa**: **emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore**.

Emërore	<b>laps</b>	<b>vajza</b>	<b>fletoret</b>	<b>malet</b>
Gjinore	<b>(i,e) lapsit</b>	<b>(i, e) vajzës</b>	<b>i, e fletoreve</b>	<b>(i,e) maleve</b>
Dhanore	<b>lapsit</b>	<b>(vajzës</b>	<b>fletoreve</b>	<b>maleve</b>
Kallëzore	<b>lapsin</b>	<b>vajzën</b>	<b>fletoret</b>	<b>malet</b>
Rrjedhore	<b>lapsit</b>	<b>vajzës</b>	<b>fletoreve</b>	<b>maleve</b>



## Ushtrime

Lidh me shigjetë rasën me emrin!		Lidh me shigjetë rasën me emrin!	
Emërore •	•aeroplanin	Emërore•	•(i, e) nënës
Gjinore•	•prej aeroplanit	Gjinore•	•nënë
Dhanore•	•aeroplanit	Dhanore•	•prej nënës
Kallëzore•	•aeroplani	Kallëzore•	•nënës
Rrjedhore•	•i aeroplanit	Rrjedhore•	•nëna

## Detyrë

1. Shkruaj pesë fjali ku emri të jetë në rasi të ndryshme!

---



---



---



---



---

2. Mendo: Sa rasi ka në gjuhën e vendit ku jeton ti, si quhen ato rasi?

Mbani në mend!

Për të gjetur rasi e emrit përdorim pyetje të ndryshme: **kush, cili, cila, kujt** etj.

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E. kush? cili? cila? cilët? cilat?	(një) vajzë / djalë	vajza / djali
Gj. i kujt? e kujt? të kujt?	(i/e) (një)vajze / djali	(i/e) vajzës / djalit
Dh. kujt? cilit? cilës? cilëve? cilave?	(një) vajze / djali	vajzës / djalit
K. kë? cilin? cilën? ç? cilët? cilat?	(një) vajzë / djali	vajzën / djalin-
Rr. Prej kujt? prej cilit? prej cilëve? prej cilave?	(një) vajze / djali	vajzës / djalit

### Mbani në mend!

Me pyetjet **kush?**, **i/e kujt?**, **prej kujt** – pyesim vetëm për njerëz, ndërsa me pyetjet **cili?**, **cilit?**, **prej cilit?** – pyesim për njerëzit, për kafshët dhe për sendet. Me pyetjen **ç?** – pyesim vetëm për kafshë e sende.

### Detyrë

**Bëni në një fletë një tabelë me pesë raset. Shënoni në atë tabelë emrat e shtypur me ngjyrë të kuqe në tekstin vijues.**

Papritur e pa kujtuar **zanat** e **malit** e humbasin tërë **fuqinë**. Bëjnë të fluturojnë e s'fluturojnë dot. **Shtatin** e kanë shtëng të rëndë ... I thonë **erës** të fishkëllejë nëpër **ahet**: **era** nuk fishkëllen. Atëherë kujtohen e ndjellin **dhitë** e egra me brirë të artë. Dhitë nuk u vijnë. Dalin t'i kërkojnë **lugjeve** e **krepave**; mezi hedhin **hapin**. Dhitë nuk i shohin gjëkund, nuk ua ndiejnë **erën** e **blegërimën**.

*Mitrush Kuteli: "Tregime të moçme shqiptare"*

## Drejtshkrim

### PËRDORIMI I SHKRONJËS SË MADHE

#### Lexojmë:

Unë jam **Bardha Mataj**. Jetoj me familje në **Gjenevë**. Me shoqen time **Mariana** kemi vendosur të shkojmë në **Kosovë** te gjyshërit e mi. **Ajo** ka treguar kureshtje për **Kosovën**, sepse unë vazhdimisht i flas për bukuritë e saj. **E** kush nuk do të fliste për **Rugovën**, **Prizrenin**, **Drinin** e **Bardhë** e **Mirushën**?

**Kur** të shkojmë do të vizitojmë edhe **Shtëpinë** e **Lidhjes** së **Prizrenit**, **Varret** e **Jasharajve** në **Prekaz**, **Muzeun** e **Prishtinës** vendgërmimet arkeologjike në **Ulpianë** e shumëçka tjetër.

**Jam** e bindur se **Marianës** do t'i pëlqejë **Kosova**, por do t'i pëlqejnë edhe petullat e gjyshes **Dritë** e shakatë e gjyshit **Bardhë**. **Do** të na presë me gëzim edhe qeni im **Riki** që ruan shtëpinë tonë në **Kosovë**.

Shpresoj te kënaqemi me **Marianën** në **Kosovë**

#### Çka keni vërejtur?

1. Secila fjali fillon me një shkronjë të madhe.
2. Emrat e mbiemrat e njerëzve, emrat familjarë si dhe emrat e kafshëve janë shkruar me shkronjë të madhe.
3. Emrat e vendeve, krahinave, qyteteve, fshatrave, fushave, maleve, kodrave, lumenjve janë shkruar me shkronjë të madhe.

### Ku përdoret tjetër shkronja e madhe?

Shkronja e madhe përdoret edhe në këto raste:

**-kur shkruajmë emrat e shteteve, kontinenteve, oqeanëve, deteve, liqeneve, planetëve, yjeve, shesheve, rrugëve.** Për shembull:

**E**vropa është kontinenti më i vjetër.

**S**hqipëria del në detin **A**driatik dhe në detin **J**on.

Do te doja të shkoja në **J**upiter.

Unë kam qenë me prindërit në liqenin e **O**hrit.

Më pëlqen të shëtis në sheshin “**S**kënderbej”.

Unë banoj në rrugën “**N**ëna **T**ereze”.

**- kur shkruajmë emrin e festave, ngjarjet e njohura historike:** **V**iti i **R**i, **D**ita e **M**ësuesit, **D**ita e **P**avarësisë, 28 **N**ëntori, **R**ilindja **K**ombëtare, **L**idhja e **P**rizrenit etj.

**-kur shkruajmë emrat e gazetave, revistave, veprave letrare:** “**P**ionieri”, “**Z**ogu i mëngjesit”, “**Z**ëri i rinisë”, “**H**ari **P**oteri”, “**V**erorja”, “**L**ushi si askushi” etj.

**-kur shkruajmë emërtimet e institucioneve:** **T**eatri i **K**ukullave, **S**htëpia e **F**ëmijëve, **B**iblioteka e **Q**ytetit etj.

### Detyrë

Si përdoren shkronjat e mëdha në gjuhën e vendit ku jeton?

A ka dallime nga shqipja?

## MBIEMRI

### Lexo tekstin në vijim!

Rina do të vendoset në shtëpinë **e re**. Ajo banonte më parë në një shtëpi **të vjetër** e **të vogël** afër Shkollës **së Lartë** të Muzikës. Në shtëpinë **e re** Rina e ka dhomën **më të madhe** e **më të ndritshme**. Ajo është e kthyer nga lindja dhe dielli **mëngjesor** e zgjon nga gjumi Rinën çdo ditë. Nga dritarja e dhomës së saj shihen parku **i bukur** i qytetit dhe rrugët **e gjera** e **të pastra** përreth tij. Pak më tej shihet edhe cirku **përrallor** e pishina **verore**. Të gjithë janë **të gëzuar** për shtëpinë **e re** e **të bukur**.

Fjalët e shtypura me shkronja të kuqe quhen **mbiemra**.

### Mbani në mend!

Mbiemrat janë fjalë që emërtojnë cilësi ose tipare të frymorëve, të sendeve ose të dukurive.

Mbiemrat e shtypur me shkronja të kuqe në tekstin e mësipërm: **e re, e vjetër, e vogël, e lartë, e madhe, e ndritshme, i bukur, e gjerë, e pastër, mëngjesor, përrallor, verore, të gëzuar** tregojnë cilësi të sendeve a objekteve.

### Mbani në mend !

Mbiemri zakonisht shoqëron emrin. Ai i përshtatet emrit në **gjini, numër** e në **rasë**, d.m.th. merr gjininë, numrin dhe rasën e emrit që shoqëron.

### Shihni me vëmendje!

djalë <b>lazdrak</b>	vajzë <b>llafazane</b>	lule <b>erëmirë</b>
laps <b>i kuq</b>	çantë <b>e re</b>	ujë <b>i ftohtë</b>
shtëpi <b>e madhe</b>	shtëpi <b>të mëdha</b>	dardhë <b>verore</b>
pamje <b>magjepsëse</b>	fushë <b>blerore</b>	laps <b>i mprehtë</b>
libër <b>i ri</b>	libra <b>të rinj</b>	qen <b>leshator</b>
grua <b>punëtore</b>	yll <b>ndriçues</b>	sy <b>të zinj</b>

### Lexoni tekstin në vijim dhe dalloni mbiemrat që janë të shtypur me ngjyrë të kuqe duke i shënuar në fletoret tauaja!

Frynte një puhizë **e hollë** nga malet. Kuajt ecnin bukur në freskinë **mëngjesore**, hingëllinin, lodronin... Dizdar Osman Aga rrinte **i zyrtë**, ndukte frerin me atë dorën **e hollë e të gjatë** dhe diç bluante në mendje... Disa ishin jo vetëm **të heshtur**, po edhe **të vrerosur**, sepse e dinin ç'ishte i zoti të bënte Gjeto Basho Muji, e ç'ishte i zoti të bënte Dizdar Osman Aga. Aq më fort e dinin ç'mund të bënin ata të dy bashkë me Mujin **prijës**; e dinin shumë mirë po s'donin t'ia prishnin plakut **thinjak** e **zemërak**.

Mitrush Kuteli: *Tregime të moçme shqiptare*

### Bisedojmë!

Çka keni vërejtur?

Mbiemrat ndahen në dy lloje: **të nyjshëm** e **të panyjshëm**

**a. mbiemra të nyjshëm** janë ata që kanë një të përparme: **i, e, të**.

Mbiemrat: **e hollë, i zyrtë, të gjatë, të heshtur, të vrerosur** janë mbiemra të nyjshëm, sepse kanë nyja (**i, e, të**).

**b. mbiemra të panyjshëm** janë ata që nuk marrin një të përparme.

Mbiemrat **mëngjesore, prijës, thinjak, zemërak** janë mbiemra të panyjshëm, sepse nuk kanë një.

### Ushtrime

**1. Lidhni emrin me mbiemrin përkatës sipas gjinisë!**

- |          |                |
|----------|----------------|
| ditë •   | • i kthjellët  |
| bletë •  | • shumëkatëshe |
| ujë •    | • sypatrembur  |
| djalë •  | • e ëmbël      |
| nënë •   | • punëtore     |
| mollë •  | • e bukur      |
| shtëpi • | • zemërmadhe   |

**2. Kthejini në numrin shumës grupet e fjalëve të mëposhtme!**

mollë e kuqe \_\_\_\_\_  
sportist i dalluar \_\_\_\_\_  
flamur kuqez \_\_\_\_\_  
gjyshe e dashur \_\_\_\_\_  
çantë e re \_\_\_\_\_  
djalë guximtar \_\_\_\_\_

**4. Shkruajeni një tekst me të paktën 7 fjali dhe 5 mbiemra duke shikuar ilustrimet në vijim!**



## Shkallët e mbiemrit

### Mbani në mend!

Mbiemrat mund të shprehin tri shkallë të ndryshme:

i mirë	më i mirë	shumë i mirë / më i miri, më e mira
i gjerë	më i gjerë	shumë i gjerë / më i gjeri, më e gjera
i mençur	më i mençur	shumë i mençur, më i mençuri, më e mençura

Shkallët e mbiemrit quhen kështu:

-**pohore** - Kjo vajzë është **e vyeshme**

-**krahasore** - Kjo vajzë është **më e vyeshme**

-**sipërore** - Kjo vajzë është **shumë e vyeshme / më e vyeshmja**

**Shkalla pohore** e mbiemrit tregon thjesht një cilësi:



gjyshe e dashur



rrugë e gjatë



zog i bukur

**Shkalla krahasore** e mbiemrit përdoret për të treguar një cilësi të një frymori, të një sendi a të një dukurie duke e krahasuar me një tjetër:

Besa është **më e shkathtë** se Valoni.

Valoni është **më i dashur** se Besa



**Shkalla sipërore** e mbiemrit tregon cilësinë e një frymori, të një sendi a të një dukurie në shkallë shumë të lartë ose më të lartën.



Ari është më i shkathëti.



Beni është jashtëzakonisht i shpejtë.



Gjyshja është tepër e dashur.

Kjo shkallë formohet duke i paravënë shkallës pohore pjesëzën **më: më** + i miri, **më** + e thella etj. ose **ndajfoljet: shumë, tepër, jashtëzakonisht, fort**, etj.: **shumë** më i shpejtë, **tepër** më i shpejtë etj.

### Detyrë

#### 1. Shkruajeni nga një emër që u përgjigjet këtyre mbiemrave!

_____ i ëmbël	_____ e ëmbël
_____ i qetë	_____ e qetë
_____ i zgjuar	_____ e zgjuar
_____ të gjatë	_____ të trashë

#### 2. Rishkruajeni të kundërtën e mbiemrave të mëposhtëm në vijat e zbrazëta duke ua shtuar parashtesën **pa-** sipas shembullit të parë!

bluzë	e larë	<b>e palarë</b>
shtëpi	e mbuluar	e _____
dardhë	e qëruar	e _____
mish	i pjekur	i _____
gështenjë	e zier	e _____
vajzë	e bindur	e _____
degë	e prerë	e _____

#### 3. Në tekstin në vijim gjejini mbiemrat dhe dalloni shkallën e tyre!

Nënvizoni mbiemrat në shkallën pohore me ngjyrë të zezë, në shkallën krahasore me ngjyrë **blu** dhe në shkallën sipërore me ngjyrë **të kuqe**.

Një ditë vere Ana me mamin e babin shkoi në pyll.

Ishte ditë **e nxehtë**, por pylli ishte i freskët. Nëna kishte bërë bukë të bardhë dhe kulaç me reçel, kishte mbushur çantën me mish të pjekur, kishte vënë edhe djathë, domate të reja, shumë pjeshkë, e po aq mollë e dardhë.

Të gjithë ishim shumë të gëzuar. Ana e vogël ishte bërë e kuqe në fytyrë, ndërsa sytë i qeshnin plot shend. Sytë i dukeshin edhe më të kaltër se të tjera herë. Derisa po e shikonte, babai po mendonte: “Sa e mirë që është, më e mira ndër të gjithë fëmijët, është edhe shumë e zgjuar, më e zgjuara në fshat. Do të bëhet edhe e vyeshme kur të rritet ...” Babi e nëna ishin tepër krenarë me vajzën e tyre të vogël e të dashur.



#### 4. Si bëhet shkallëzimi i mbiemrave në gjuhën e vendit ku jeton ti? Krahaso!

## P Ë R E M R I

### Lexo tekstin në vijim!

Gjyshja erdhi **atë** ditë te **ne**. **Unë** e prita me shumë gëzim, sepse **ajo** kishte kohë pa ardhur. Edhe babai u duk se u gëzua shumë. Menjëherë mori shportën e doli në treg për të blerë frutat që i pëlqejnë **asaj**. Gjyshja mori çantën e **saj** dhe nxori gurabijet që i kishte përgatitur për **ne**, fëmijët.

-I solla për **ju** të dy se e di se i shijoni fort – tha duke përkëdhelur flokët **e mi** dhe të Arit. **Ne** buzëqeshëm të gëzuar, kurse **ajo** vazhdoi të nxirrte edhe peshqeshet **e tjera** që kishte përgatitur **këto** dite për **të gjithë ne**.

Fjalët e ngjyrosura me të kuqe quhen **përemra**.

### Mbani në mend

**Përemrat janë fjalë të ndryshueshme që përdoren në vend të emrave e të mbiemrave. Ata përdoren për të treguar ose për të pyetur për frymorë, sende ose dukuri.**

**Përemrat e ngjyrosur me të kuqe në tekstin e mësipërm: atë, ne, unë, ajo, asaj, ju, (e) mi, ajo, e tjera, këto, të gjithë zëvendësojnë emrat.**

**Përemrat dallohen në lloje të ndryshme. Në vijim do të njiheni me përemrat vetorë, dëftorë, pronorë dhe pyetës.**

## Përemrat vetorë

### Mbani në mend!

**Përemrat vetorë janë fjalë që tregojnë kush flet, me kë flasim dhe për kë flasim (frymor, send, dukuri).**

	njëjës	shumës
veta I	unë	ne
veta II	ti	ju
veta III	ai, ajo	ata, ato

**Përemri vetor ka vetë (unë, ti etj.) dhe numër (njëjës dhe shumës)**

### Mbani në mend!





**Kur duam t'i drejtohem dikujt me respekt atëherë në vend të përemrit **ti** në numrin njëjës përdorim shumësin **ju**. Për shembull:**



-Ju, axhë, ishit i pari në radhë.

-Ju, jeni babai i Rinës?

Në vetën e **tretë** përemrat dallohen sipas **gjinisë**:

mashkullor		femëror	
			
ai	ata	ajo	ato

### Ushtrime:

#### 1. Në tekstin e mëposhtëm dallo dhe ngjyros përemrat vetorë.



**Unë** jam Albi. Kam një motër e një vëlla. Ata janë më të mëdhenj se unë. Neve na pëlqen të luajmë bashkë.

Çdo të shtunë ne shkojmë te gjyshja. Ajo përgatit ëmbëlsirë për ne, por gjithmonë më thotë mua:

– Vetëm për ty i kam përgatitur, sepse ti je më i vyeshmi. Sigurisht edhe atyre u thotë të njëjtën gjë, sepse unë e di se edhe ata i do shumë sikur mua.

#### 2. Shkruaj sipas dëshirës nga tri fjali duke përdorur përemra vetorë në numrin njëjës dhe shumës! \_\_\_\_\_

---

---

---

---

---

---

---

---

3. Shkruaj për çdo figurë përemrat: unë, ti, ai, ne, ju, ata!



\_\_\_\_\_ kam ditëlindjen.




\_\_\_\_\_ je e trishtuar.



\_\_\_\_\_ vjel pemë.



\_\_\_\_\_ vallëzojmë në akull.



\_\_\_\_\_ jeni të gëzuar.



\_\_\_\_\_ zbukurojnë bredhin.

**Përemrat dëftorë**

**Mbani në mend!**

Përemrat dëftorë janë fjalë që tregojnë sende a frymorë që ndodhen afër ose larg folësit. Përemrat dëftorë në një mënyrë i zëvendësojnë ose i përcaktojnë emrat.

**Përemrat dëftorë janë:**

**afër:** ky, kjo, këta, këto  
i këtillë, e këtillë, të këtillë, të këtilla  
i tillë, e tillë, të tillë, të tilla

**larg:** ai, ajo, ata, ato  
i atillë, e atillë, të atillë, të atilla  
P.sh.:



**Ky** po vrapon shpejt.  
**Ai** po vrapon shpejt.




**Kjo** noton mirë.  
**Ajo** noton mirë.



**Këta** luajnë bukur.  
**Ata** luajnë bukur.

## Ushtrime.

1. Vendos përemrat dëftorë **ky, ai, këta, ata, kjo, ato** në fjalitë përkatëse!



\_\_\_\_\_ lule vallëzon.



\_\_\_\_\_ janë lule dielli.



\_\_\_\_\_ top është bardhë e zi.



\_\_\_\_\_ profesor po shpjegon.



\_\_\_\_\_ djalë po mendon.



\_\_\_\_\_ nxënese po ushtrojnë.



\_\_\_\_\_ zonjë po pret.



\_\_\_\_\_ janë qen dalmatinë.

## Përemrat pronorë

Mbani në mend!

Përemrat pronorë tregojnë kujt i përket diçka.

I kujt është ky libër? **Imi.**

Kjo lule është **e saj.**

Shtëpitë janë **tonat.**

Fëmija është **i tij.**

A është **i yti** ky laps?

Fjalët e ngjyrosura me shkronja të kuqe: **imi, e saj, tonat, i tij, i yti** quhen **përemra pronorë.**

### Mbani në mend!

Përemrat pronorë kanë **gjini**, **numër** edhe **rasë**. Ashtu sikurse mbiemrat, edhe këta përshtaten me emrat. Zakonisht përdoren pas emrit.



Vajza ime



Klasa jonë



Ormani i saj



Bredhi ynë



Librat e tij



Kompjuterët e tyre

### Detyra

1. Vendos në fjalitë e poshtëshënuara këta përemrat pronorë: **yt, e tu, e tua, e saj, e tij, i tyre, e tyre!**

Kjo është çanta ..... Kjo është fletorja ..... Ky është lapsi .....

Ky është libri ..... Ky është libri ..... Ky është libri .....

Këto janë kushërirat ..... Këto janë kushërirat..... Këto janë kushërirat .....

Këta janë prindërit ..... Këta janë prindërit ..... Këta janë prindërit .....

2. Gjej e nënvizo përemrat pronorë!

Në familjen **tonë** secili prej nesh ka albumin e tij. Albumi im ka shumë fotografi. Aty është gjithshja e gjyshi im, prindërit e mi dhe motrat e mia. Në albumin tim kam vendosur edhe fotografitë e shoqeve të mia, por edhe të kushërinjve tanë nga Kosova.

Harto në fletoren tënde një tekst të shkurtër duke përshkruar dhomën tënde. Përdor sa më shumë përemra pronorë!

---

---

---

---

---

---

---



## Përemrat pyetës

Mbani në mend!

Përemrat pyetës përdoren për të pyetur për frymorë, sende a dukuri.  
Përemrat pyetës përdoren në fjalitë pyetëse

**Të shohim!**

**Kush** po thërret?  
**Cili** do t'ia fillojë?  
**Cila** pamje të pëlqen?  
**Çfarë** ke që qan?  
**Ç'**është kjo zhurmë?  
**Sa** gota ju duhen?  
**Si** e do qumështin?  
**I sati** ishe në garë?  
**Me se** erdhi gjyshja?

Përemri **kush** përdoret vetëm kur pyesim për frymorë, kurse përemri **cili** për frymorë dhe jofrymorë.

### Ushtrime

1. Sajoni disa fjali me përemrat **kush, cili (cila), sa, i sati, çfarë, kë, kujt!**

Kush \_\_\_\_\_

Cili \_\_\_\_\_

Sa \_\_\_\_\_

Kujt \_\_\_\_\_

Çfarë \_\_\_\_\_

Kë \_\_\_\_\_

I sati \_\_\_\_\_

Mbani në mend!

Përemri **ç'** përdoret gjithmonë me apostrof.

### Detyrë

Shkruani pesë fjali me përemra pyetës duke shikuar ilustrimin!



## Drejtshkrimi

### PËRDORIMI I APOSTROFIT

Shenja ' , që vihet për të treguar se nuk duhet të shkruhet tingulli ë në fund të disa fjalëve të patheksuara quhet **apostrof**.

Apostrofi përdoret në këto raste:

- në trajtat e shkurtra të përemrave vetorë: **m'i, t'i, m'u, t'u, t'ia** etj.:

Ti **m'i** the fjalët më të mira.  
Blerta **t'i** dha të hollat.  
Genti nuk **m'u** përgjigj shpejt.  
Ai **t'u** lut **t'ia** marrësh librin.

- në fjalëzën të të foljes: **t'i, (do) t'i, t'ju:**

Unë duhet **t'i** shkruaj nënës  
Ti do **t'i** thuash atij se nuk e ke sjellë librin.  
Unë do **t'ju** ftoj në ditëlindjen time.

- pas përemrit pyetës **ç':**

**Ç'**do Ema në këtë kohë te ne?  
**Ç'**zemër të bardhë që ka ajo!

- pas pjesëzës mohuese **s':**

**S'**i besoj atij që më gënjeu.  
Ai **s'**erdhi sepse u sëmure.

#### Ushtrime

**Plotëso fjalitë me ndërtime ku përdoret apostrofi!**

Gjergji këndoi bukur, por .... shpërblye.  
Nëna ..... dha fotografitë e gjyshes.  
Ti duhet ..... thuash asaj të vërtetën.  
.... vajzë e edukuar është Arta!  
Dua ..... bëj me dije se do të jem atje të hënën.  
..... e do atë lule?

#### Detyrë

**Shkruani dhjetë fjali ku do ta përdorni apostrofin!**

## FOLJA

### Lexojmë himnin e flamurit

#### Himni i Flamurit

Rreth flamurit të përbashkuar,  
Me një dëshirë me një qëllim,  
Të gjithë Atij **duke u betuar**,  
**Të lidhim** besën për shpëtim.

Prej lufte veç ai **largohet**,  
Që **është lindur** tradhëtor  
Kush është burrë nuk **frikohet**,  
Po **vdes**, po **vdes** si një Dëshmor.

Në dorë armët **do t'i mbajmë**,  
**Të mbrojmë** Atdheun në çdo vend,  
Të drejtat tona ne **s'i ndajmë**,  
Këtu armiqtë **s'kanë** vend.

Se Zoti vet **e tha** me gojë,  
Që kombe **shuhen** përmbi dhë,  
Po Shqipëria **do të rrojë**,  
Për të, për të **luftojmë** ne.

*Asdreni*



Fjalët me shkronja të kuqe: **duke u betuar, të lidhim, largohet, është lindur, frikohet, vdes, do t'i mbajmë, të mbrojmë, s'i ndajmë, s'kanë, tha, shuhen, do të rrojë, luftojmë** në poezinë "Himni i flamurit" të Asdrenit janë **folje**.

#### Mbani në mend!

Foljet janë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës që tregojnë **veprime** ose **gjendje**. Kur një folje e vëmë në vetat e ndryshme (unë, ti, ai/ajo, ne, ju ata/ato) quhet **zgjedhim i foljeve**.

Shëno ç'veprime a ç'gjendje shihen në ilustrimet e paraqitura më poshtë:



Unë \_\_\_\_\_



Ti \_\_\_\_\_



Ai \_\_\_\_\_



Ne \_\_\_\_\_



Ju \_\_\_\_\_



Ata \_\_\_\_\_



Mbani në mend!

Folja ka tri kohë:

koha e shkuar	koha e tashme	koha e ardhme
---------------	---------------	---------------



Kur **isha** i vogël...  
Kur **kam qenë** i vogël  
Kur **qeshë** i vogël



Unë **po skijoj**.



Unë **do të bëhem** pilot.

Mbani në mend!

**Koha e tashme** tregon se veprimi kryhet në çastin kur flasim.

**Koha e ardhshme** tregon se veprimi do të kryhet pas çastit kur flasim.

**Koha e shkuar** tregon se veprimi është kryer para çastit kur flasim.

Në kohën e shkuar dallojmë

- a) **kohën e pakryer** (unë isha, ti shkoje, ai/ajo punonte etj.)
- b) **kohën e kryer e thjeshtë** (unë qeshë, ti shkove, ai/ajo punoi etj.)
- c) **kohën e kryer** (unë kam qenë, ti ke shkuar, ai/ajo ka punuar etj.)

## Ushtrime

Lidh me shigjetë foljet në të dy kolonat me kohët përkatëse!

Unë <b>luaja</b> balet.	e tashme	Ari <b>fjeti</b> shpejt
Ti <b>ke luajtur</b> dje me qenin tim.	e pakryer	Vali <b>do të vijë</b> shpejt
Ai <b>do të luajë</b> në piano.	e kryer e thjeshtë	Rina <b>po ikte</b> me shpejtësi
Beni <b>luajti</b> për ekipin tonë	e kryer	Ju <b>po mësoni</b> ?
Leka <b>luan</b> bukur.	e ardhme	Blerta <b>ka veshur</b> fustan.
Unë <b>kam ecur</b> zbathur.		Rina <b>vallëzon</b> me lehtësi.

## Mbani në mend!

Koha e kryer formohet me dy folje (p.sh. “kam punuar”, “jam përgjigjur”. Ajo quhet **koha e përbërë**. Ajo quhet kështu sepse përbëhet prej foljeve ndihmëse **jam** dhe **kam** dhe pjesores së foljes **punuar**: unë kam punuar, unë jam përgjigjur.

Kohët e tjera, të cilat formohen vetëm me një folje (punoj, shkojmë) quhen **kohë të thjeshta**.

## Detyrë

Në tekstin në vijim dallo foljet në kohët e thjeshta dhe në kohët e përbëra! Nënvizohet foljet në kohët e përbëra me ngjyrë **të kuqe** dhe foljet në kohët e thjeshta me ngjyrë **të gjelbër**!

Atë ditë **jam zgjuar** më vonë se herë të tjera. Kur po **shikoja** nga dritarja, vërejtja se po lëvizte diçka. Më kapi një frikë që as sot nuk di si ta shpjegoj. Dola me shpejtësi nga dhoma dhe thirra motrën. Nuk po dëgjohej asnjë zë. Të gjithë kishin ikur në kopsht, Vërtet, ishte kohë vape e padurueshme. A kam fjetur, vërtet, aq gjatë? – pyes veten derisa po shëtis nëpër dhoma.

Një ditë më parë te ne kanë ardhur mysafire kushërirat nga qyteti. Ato ishin shumë kureshtarë për të parë çdo gjë në fshatin tonë. Më shkoi mendja mos kisha mbetur vetëm! Sërish më kapi frika. Edhe një herë do të kthehem në dhomë, - i them vetes. Zgjas kokën nga dritarja. Përsëri dëgjoj zhurmë. Oh, jo, dëgjoj rënkim! E trembur fare i afrohem dritares duke u përpjekur të shoh diçka më tepër. Kur ç'të shoh! Një lepur i plagosur, i shtrirë përdhe po më shikonte me sy tepër pikëllues, thuajse po më kërkonte ndihmë....

Atë ditë jam ndier edhe unë shumë e pikëlluar.



## Foljet *jam* dhe *kam*

### Mbani në mend!

Foljet **jam** e **kam** përdoren si folje me kuptim të pavarur, por edhe si folje ndihmëse për të formuar kohët e përbëra të foljeve të tjera.



Unë **jam** në kopsht.  
Unë **kam punuar** në kopsht.



Ne **ishim** në festë.  
Ne **kemi shkuar** në festë.



Ti **je** në kuzhinë.  
Ti **ke** gatuar mirë.



Ajo **është** nën tavolinë.  
Ajo **ka fjetur** nën tavolinë.



Ju **ishit** në cirk.  
Ju **keni shkuar** në cirk.



Ata **janë** në shtëpi.  
Ata **janë vendosur** në shtëpi.

### Ushtrime!


Shkruaj foljet **jam** ose **kam** si folje kryesore dhe si folje ndihmëse, sipas dëshirës, në fjalitë nën ilustrime!



Unë **kam** kapuç.



Ti \_\_\_\_\_ një biçikletë të re.



Ajo \_\_\_\_\_ e bukur.

Unë **kam pasur** kapuç.

Ti \_\_\_\_\_ një biçikletë të re.

Ajo \_\_\_\_\_ e bukur.



Ne \_\_\_\_\_ të gëzuar.



Ju \_\_\_\_\_ kapela.



Ata \_\_\_\_\_ binjakë.

Ne \_\_\_\_\_ të gëzuar.

Ju \_\_\_\_\_ kapela.

Ata \_\_\_\_\_ binjakë.

Folja **jam** zgjedhohet në këtë mënyrë:

e tashme	e kryer e thjeshtë	e pakryer	e kryer	e ardhme
Unë jam	Unë qeshë	Unë isha	Unë kam qenë	Unë do të jem
Ti je	Ti qe	Ti ishe	Ti ke qenë	Ti do të jesh
Ai,ajo është	Ai, ajo qe	Ai, ajo ishte	Ai, ajo ka qenë	Ai,ajo do të jetë
Ne jemi	Ne qemë	Ne ishim	Ne kemi qenë	Ne do të jemi
Ju jeni	Ju qetë	Ju ishit	Ju keni qenë	Ju do të jeni
Ata, ato janë	Ata, ato qenë	Ata, ato ishin	Ata, ato kanë qenë	Ata, ato do të jenë

Folja **kam** zgjedhohet në këtë mënyrë:

e tashme	e kryer e thjeshtë	e pakryer	e kryer	e ardhme
Unë kam	Unë pata	Unë kisha	Unë kam pasur	Unë do të kem
Ti ke	Ti pate	Ti kishe	Ti ke pasur	Ti do të kesh
Ai,ajo ka	Ai, ajo pati	Ai, ajo kishte	Ai, ajo ka pasur	Ai,ajo do të ketë
Ne kemi	Ne patëm	Ne kishim	Ne kemi pasur	Ne do të kemi
Ju keni	Ju patët	Ju kishit	Ne kemi pasur	Ju do të keni
Ata,ato kanë	Ata, ato patën	Ata,ato kishin	Ju keni pasur Ata, ato kanë pasur	Ata, ato do të kenë

2.) Krahaso foljet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e vendit ku jeton:

a) A ka folje në atë gjuhë? Shëno pesë folje!

b) A mund të zgjedhohen (të vihen në veta të ndryshme: unë, ti, ai/ajo etj.) foljet në këtë gjuhë? Provoje me një shembull!

c) A ka kohë të thjeshta dhe të përbëra të foljeve në këtë gjuhë? Shëno ca shembuj!

## NDAJFOLJA

### Lexoni fjalitë:

Zana këndon **bukur**.

U bëmë gati **shpejt**, sepse gara do të fillonte **herët**.

Ata na pritën **bujarisht**.

**Përse** po e e qortoje vajzën?

Vjet ata ishin më të **zellshëm**.

Ari po ecte **djathtas** shtëpive.

Mos shkel **kështu** në bar.



Fjalët me shkronja të kuqe quhen **ndajfolje**.

**Mbani në mend!**

Ndajfolje quajmë fjalët e pandryshueshme që plotësojnë foljet.  
Ato tregojnë mënyrë, vend, kohë, shkak, sasi.

**Radhit këto ndajfolje sipas përcaktimit që ua bëjnë foljeve:**

pasdite, bukur, pastër, prandaj, larg, djathtas, ashtu, nesër, papritur,  
përse, shkurt, keq, kurrkund, andej, shumë, vonë, anembanë,  
bujarisht, për këtë arsye, thellë, përballë, kështu,

ndajfolje e kohës

ndajfolje e vendit

ndajfolje e mënyrës

ndajfolje e sasisë

ndajfolje e shkakut

## Detyra

### 1. Nënvizoni ndajfoljet në fjalitë vijuese!

Gjyshja ishte shumë e dashur, prandaj na priste gjithmonë gëzueshëm.  
Më mungon shumë ai vend i vogël në bjeshkët e Sharrit.  
Njerëzit e moshuar thonë se në fshat jetohet më mirë.  
Vjershat e tij atëherë lexoheshin pak.  
Babai e priti lajmin zemërhapur.  
Ju lutem, ecni më shpejt dhe majtas.

### 2. Sajo vetë një tekst me të paktën 5 ndajfolje të ndryshme!

#### Mbani në mend!

Ndajfoljet mund të plotësojnë edhe mbiemrat ose ndajfoljet e tjera.

#### Shembuj:

Ai bënte gjumë shumë të thellë.  
Pranvera erdhi tepër herët.

### 3. Plotëso fjalitë me ndajfoljet që plotësojnë mbiemra ose që dyfishojnë ndajfoljet.

Leka solli një libër \_\_\_\_\_ të vjetër.  
Vera erdhi \_\_\_\_\_ më vonë.  
Atë film e kam parë \_\_\_\_\_ herë.  
Ti thua se ajo ishte \_\_\_\_\_ e vyeshme.

#### Mbani në mend!

Ndajfoljet dallojnë prej mbiemrave ngase nuk kanë nyjat (i, e, të).

#### Shembull:

ndajfolje	mbiemra
butë	i/e butë
rreptë	i/e rreptë
lart	i/e lartë
këndshëm	i/e këndshëm
ftohtë	i/e ftohtë

## Detyra

### 1. Lexojeni tekstin në vijim duke nënvizuar ndajfoljet me të kuqe e mbiemrat me të kaltër!

Rina shkon në shkollën që gjendet afër shtëpisë së saj. Ajo është dykatëshe dhe gjendet përballë kinemasë. Në anën e djathtë të shkollës gjendet tregu i vogël i qytetit. Në anën e saj veriore, pak më larg rrethojës së shkollës, qëndron një dru tepër i lartë dhe shumë i moçëm. Druri bën hije të gjerë e të freskët. Nxënësit shpesh mblidhen nën të dhe bisedojnë gjerë e gjatë për mësimet e lojërat e tyre.

Rina fillon mësimin në mëngjes herët. Ajo nuk vonohet kurrë. Në mesditë ajo kthehet shend e verë në shtëpi, e gatshme të tregojë për të gjitha ato që ka mësuar e dëgjuar në shkollë.

### 2. Gjeni antonimet (të kundërtën) për ndajfoljet:

shumë \_\_\_\_\_

poshtë \_\_\_\_\_

herët \_\_\_\_\_

shpesh \_\_\_\_\_

sot \_\_\_\_\_

mirë \_\_\_\_\_

### 3. A di ti si quhen ndajfoljet në gjuhën e vendit ku jeton? \_\_\_\_\_

Shëno disa ndajfolje në atë gjuhë! \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## PARAFJALA

### Lexojmë tekstin:

Në qytetin ku jetoj kam shumë shokë. Alba është nga Tirana, Danieli nga Bukureshti, kurse Misheli e Valeria nga Gjeneva. Ata banojnë në pallatin pranë shtëpisë sime. Shpesh luajmë mbi platonë që gjendet nën katin përdhes të pallatit. Prej lojërave të shumta që luajmë, më së shumti më pëlqen loja fshehtas. Ndonjëherë shkojmë te parku afër. Edhe atje kënaqemi duke shëtitur anës lulishtes me trëndafilave. Era e trëndafilave na ndjek deri në fund të shëtitorës.



Në tekstin që shkroi Ari në fletoren e tij disa fjalë janë ngjyrosur me të kuqe. Fjalët e ngjyrosura **në, nga, mbi, nën, prej, pranë, te, me, anës** quhen **parafjalë**.

### Mbani në mend!

Parafjala është një lloj fjalësh i pandryshueshëm. Parafjalët na thonë p.sh. ku gjendet diçka (libri gjendet **në/mbi/nën** tavolinë). Parafjalë të tjera na thonë nga është dikush a diçka (ai është **prej** Kosovës, ajo vjen **nga** Shkupi) apo ku shkon dikush (ata shkojnë **në** Suedi, ne shëtisim **nëpër** Kosovë).



## Detyra

1. Në fjalitë vijuese vendos në vendin e duhur parafjalët: **në, për ku, përmbi, te, përtej, nëpër, për nga, prej!**

Ata rrinë \_\_\_\_\_ parkun përballë.

Besa erdhi \_\_\_\_\_ shtëpisë.

\_\_\_\_\_ është nisur mami?

Tezja kishte vendosur \_\_\_\_\_ tavolinë vazon me lule

Mos ecni \_\_\_\_\_ lulishte!

Dallëndyshja fluturoi \_\_\_\_\_ pullaz.

Pata futi kokën \_\_\_\_\_ ujë.

2. Plotëso fjalitë me parafjalët e duhura!

Dy dallëndyshet fluturuan \_\_\_\_\_ çatinë e shtëpisë sime.

Rina mori librin \_\_\_\_\_ Ari.

Gjyshen e kishte marrë malli shumë \_\_\_\_\_ për nipërit e saj.

Ata i ranë \_\_\_\_\_ qytetit duke kërkuar një vendpushim të flladshëm.

Thellë \_\_\_\_\_ tokë ruhen pasuritë tona.

3. Shiko ilustrimin dhe shkruaj dhjetë fjali me këto parafjalë: **me, te, pa, nëpër, sipër, përmes, sipas, përpara, buzë**



4. Si quhen parafjalët në gjuhën e vendit ku jeton ti? \_\_\_\_\_

Shëno ca parafjalë në këtë gjuhë dhe jep në kllapa përkthimin shqip!

---

---

---

## LIDHËZA

### Lexojmë me vëmendje!

Atë ditë unë **e** motra u nisëm për në Tiranë. Me ne erdhën **edhe** dy kushërirat tona më të mëdha. **Ashtu siç** kishim pritur, arritëm në mesditë. Në aeroport kishin dalë të na prisnin gjyshi **e** gjyshja, **por edhe** axha e halla. **Kur** na panë vrapuan drejt nesh, **ndërsa** ne, të gëzuara së tepërmi, thirrëm me sa zë që kishim emrat e tyre. Gjyshja si e ka zakon na shtrëngoi fort **e** sytë iu mbushën me lot.

Atje qëndruam gati dy javë, **sepse** ishte kohë pushimesh. Koha kaloi shumë shpejt **e** ne numëronim ditët. Gjithë ditën shëtisnim nëpër qytetet **e** fshatrat përreth, **kurse** në mbrëmje kënaqeshim me llafet **e** shakat e gjyshes **e** të gjyshit.

Koha për t'u kthyer erdhi shpejt. Ditën që po niseshim, **kur** aeroplani po shkëputej prej tokës, ne shihnim gjyshen duke na përshëndetur me te dyja duart. Ajo vazhdoi të na përshëndeste **derisa** fluturoam shumë lart e **derisa** ata nuk shiheshin më.

Ishte një pushim për t'u mbajtur në mend gjatë, **edhe pse** i shkurtër për planet që kishim bërë.

**Fjalët e ngjyrosura me të kuqe: e, edhe, ashtu siç, por edhe, ndërsa, sepse, kur, po, por, derisa, edhe pse - quhen lidhëza.**

### Mbani mend!

Lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme që shërbejnë për të lidhur midis tyre fjalë, grupe fjalësh ose fjali.

### Detyrë

Vendos lidhëzat **e, edhe, ose, por, mirëpo, derisa, andaj, në qoftë se, kur** në fjalitë në vijim!

Rina \_\_\_\_\_ Ari u nisën për në fshat.

Të dielën kisha ndërmend të shkoja në pyll, \_\_\_\_\_ u sëmura.

Leka do të qëndrojë këtu \_\_\_\_\_ të mbarojë viti shkollor.

Nuk isha në shtëpi \_\_\_\_\_ erdhën halla me fëmijët e saj.

\_\_\_\_\_ është nevoja ata na i dërgojnë menjëherë ftesat.

Ti ishe më e mira, \_\_\_\_\_ hyre në finale.



## FJALIA

**Lexojmë tekstin në vijim!**

### **Kjo është shtëpia ime**

Kjo është shtëpia ku kam lindur. Ka mbetur e njëjtë sikur vite më parë. Nën hijen e këtyre drunjve, gjithë verën, ne kalonim ditët e gjata përvëluese. Nga shtrati turrëshim kush më parë në oborr, rreth tavolinës së drunjve, dhe zinin secili vendin e vet. Aty bëheshin bisedat e mëngjesit, të mesditës e të mbrëmjes. Po aty hanim mëngjesin, drekën e darkën, ndërsa nëna e babai, gjyshi e gjyshja pinin kafetë e tyre të ëmbla, e ne na dehte era e tyre e na bënë të qeshnim hurpat e gjyshit që dëgjoheshin deri në fund të oborrit.



Fjalja është bashkim i disa fjalëve që na tregojnë diçka. Ajo fillon me një shkronjë të madhe dhe mbaron me një pikë (.), me një pikëpyetje (?) ose me një pikëçuditje (!)

### **Detyra**

**1. Teksti i mësipërm përbëhet prej disa fjalive.**

Numëroji ato. Sa janë? \_\_\_\_\_

**2. Shkruaj një tekst me pesë fjali për shtëpinë tënde!**

---

---

---

---

## Fjalitë e thjeshtë dhe fjalitë e thjeshtë të zgjeruara

### Lexojmë!

- 1) Vajza lexonte librin.
- 2) Vajza e **tij** lexonte librin **mbi kafshët**.

- 1) Nxënësit e nisën garën.
- 2) Nxënësit **tonë** e nisën garën **pasdite**.

- 1) Rrezet e diellit shkëlqyen.
- 2) Rrezet e **ngrohta të** diellit shkëlqyen **herët në mëngjes**.

### Bisedojmë!

Fjalitë me numër 1) quhen **fjalitë të thjeshta**. Atyre nuk mund t'u hiqet asnjë fjalë, sepse mbeten të pakuptimta.

Kur grupi emëror dhe grupi foljor zgjerohen me mbiemra, ndajfolje ose fjalë të tjera, atëherë kemi **fjalitë të thjeshta të zgjeruara**. Të tilla janë fjalitë me numër 2.

### Detyra

1. Përcakto **fjalitë e thjeshta** dhe **fjalitë e thjeshta të zgjeruara** në tekstin në vijim duke i shënuar ndaras në dy kolona!

Dera e madhe e shtëpisë u mbyll. Dolëm në rrugë. Bora binte pa pushim. U nisëm me shpejtësi. Vajzat nuk i morëm se flinin ende. Rrugës na u bashkuan edhe të tjerë. Afër mesditës ishim të lodhur. Edhe uria na kishte zënë. Kishim pak ushqime me vete. Askush nga ne nuk e dinte nëse do të mund të arrinin deri në vendin për ku ishim nisur.

2. Shkruaj nga pesë fjalitë të thjeshta dhe të thjeshta të zgjeruara.

---

---


---

---

---

---

---



## Llojet e fjalisë

### Lexojmë fjalitë në vijim dhe analizojmë ku dallojnë ato.

- |                                        |                                         |
|----------------------------------------|-----------------------------------------|
| 1. Atë ditë të gjithë ishin të gëzuar. | Unë sapo erdha nga biblioteka e qytetit |
| 2. Pse je mërzitur kështu?             | A do të vini me ne ne cirk?             |
| 3. Kujdes, eja kënde!                  | Të lutem, ma jep fletoren!              |
| 4. Ah, sikur të vinte edhe babai!      | Urimet Viti i Ri!                       |

Dy fjalitë e para na tregojnë diçka prandaj quhen **fjali dëftore**.

Në fund të fjalisë dëftore shkruajmë pikë (.).

Dy fjalitë e dyta shprehin pyetje prandaj quhen **fjali pyetëse**.

Në fund të fjalisë pyetëse shkruajmë pikëpyetje (?).

Dy fjalitë e treta shprehin nxitje prandaj quhen **fjali thirrmore**.

Në fund të fjalisë nxitëse shkruajmë pikëçuditje (!).

Dy fjalitë e katërta shprehin dëshirë prandaj quhen **fjali dëshirore**.

Në fund të fjalisë dëshirore shkruajmë pikëçuditje (!).

### Detyrë

Lexoni fjalitë brenda grafikonit dhe shënoni pranë tyre se çfarë fjalish janë!


Ku ishe ti?	fjali pyetëse
Ne ishim në shëtitje.	
Ah, sa më pëlqen akullorja!	
Eja më shpejt, mund të fillojë filmi!	
Sot është ditë e diel.	
Sa është e madhe motra jote?	
Sikur të dije të notoje!	

### Mbani në mend!

**Fjalitë dëftore** tregojnë diçka ose shpreh gjendje, mendime, qëndrime a vlerësime. Ajo përdoret më së shpeshti në rrëfime e përshkrime.

## Detyrë

Shkruaj gjashtë fjali dëftore duke përshkruar ilustrimet më poshtë!



---

---

---

---

---

## Mbani në mend!

**Fjalja pyetëse** përdoret kur pyesim diçka dhe presim përgjigje. Ajo përdoret më së shpeshti kur bisedojmë ose në dialogët.

## Në tekstin në vijim gjej dhe nënvizo fjalitë pyetëse!

- Ku ishe? – më pyeti nënëmadhja. – Pse je nxirë kështu?
- Mbi çati (pullaz), - iu përgjigja.
- E ç'bëje mbi çati? - mor djalë, - do të na hapësh pikat e do të na pikojë prapë shtëpia.
- Jo, nëno, unë eci me kujdes.
- Kujdes ziu – tha ajo – Eja, apo nuk ke uri?



## Mbani në mend!

**Fjalja thirrmore** përdoret për të shprehur një urdhër, një këshillë, një lutje, një ftesë, një kërkesë, një porosi etj. Ajo përdoret më së shpeshti në dialogët.

**Në tekstin në vijim gjej dhe nënvizo fjalitë thirrmore!**

Dje pas dite me Lekën shkuam në teatër. Shfaqej pjesa “Pinokio”.

- Ngutu se po vonohemi! - po i thosha Lekës, kur në rrugë pashë Rinën.

- Rina, Rina!, - e thirra me zë lartë. - Ne po shkojmë në teatër. Eja me ne!

Ajo pohoi me kokë dhe vrapoi drejt nesh. U bëmë bashkë dhe nxituam.

Në shfaqje u kënaqëm.

- Oh, sa shumë fëmijë që kishte!

Skena ishte rregulluar si asnjëherë tjetër.

Edhe Lekës i pëlqeu. Nuk u durua e më tha:

- Ari, dua të më marrësh më vete sa herë të vish në teatër!

**Detyrë**

**Shkruaj pesë fjali thirrmore duke shikuar ilustrimin!**

---

---

---

**Mbani në mend!**

**Fjalja dëshirore** përdoret për të shprehur një dëshirë, një urim, një mallkim, një vullnet. Ajo përdoret më së shpeshti në dialogët.



**Në tekstin në vijim gjej dhe nënvizo fjalitë dëshirore!**

- Uh, ç’vapë bën! – tha Zana. – Ah, sa do të doja të isha në plazhin e Golemit.

- Oh, unë do të doja të isha në flladin që lëshojnë pishat e Deçanit! – ia priti Drini.

- Jo, jo, më mirë është në Liqenin e Ohrit. Ah, sa mirë do të më bënte uji i kthjelltë i liqenit! – u ngut të fliste Era.


- A nuk është i bukur edhe pishina këtu afër nesh? – u tha Leka i gatshëm të nisej.

Të gjithë u pajtuan dhe u nisën me shpejtësi kah pishina që po ziente prej fëmijëve të zhurmsëm.



## KRYEFJALA

Leka



Ky është **Leka**.



**Leka** e do familjen e tij.



Lekës **i pëlqen** leximi.



Çdo pasdite **Leka** luan futboll.



**Leka** noton çdo ditë.



**Leka** luan tenis.

**A e dini se:**

Çdo tregim ka një hero a personazh kryesor. Heroi i tregimit tonë është djaloshi me emrin Lekë. Tregimi flet për Lekën e dëshirat e tij.

### Shikojmë fotografitë dhe bisedojmë duke u përgjigjur në pyetjet!

A ka çdo fjali që shoqëron fotografitë heroin e vet?

A mund të bëhet secila nga këto fjali tregim më vete?

heroi	veprimi
Leka	është
Leka	do
Leka	pëlqen
Leka	luan
Leka	noton
Leka	shëtit

### Duhet ta dini:

Pjesa e fjalisë që tregon atë për të cilin a cilën flitet në një fjali quhet **kryefjalë**. Kryefjala kryen veprim ose shpreh një gjendje. Kryefjalën në fjali e gjejmë me pyetjen **kush?** ose **çka?**

Të shohim!

**Kush?**

është  
do  
pëlqen  
luan  
noton  
shëtit

Përgjigjja është **Leka do, pëlqen, luan, noton, shëtit**.

Emri **Lekë** është kryefjala e të gjitha fjalive të mësipërme.

Fjalët **është, do, pëlqen, luan, noton, shëtit** janë folje, kurse në këto fjali kryejnë funksionin e kallëzuesit.

### Detyrë

Shiko me kujdes ilustrimin dhe sajo një tekst me gjashtë fjali duke nënvizuar në secilën prej tyre kryefjalën.



## KALLËZUESI

Lira



Kjo është Lira



Lira **do** familjen e saj.



Lira **lexon** çdo ditë.



Ajo **pëlqen** të vizatojë.



Çdo pasdite Lira **ushtron** balet.




Në kohën e lirë ajo **ujit** lulet.

Fjalët me shkronja të kuqe në fjalitë që shoqërojnë fotografitë: **është, do, lexon, pëlqen, ushtron, ujit** quhen kallëzues.

**Mbani në mend!**

Kallëzuesi bashkë me kryefjalën janë pjesët kryesore të fjalisë. Kallëzuesi tregon se ç'bën kryefjala, çfarë është kryefjala ose ç'pëson kryefjala. Kallëzuesi zakonisht qëndron pas kryefjalës dhe e gjejmë me pyetjet **ç'bën?, ç'është?** dhe **si është?**

### Shih kush ç'bën!



Beni **shikon** hënë.



Dea e Ari **luajnë** në pianino.



Leka **ha** akullore.



Fëmijë **rrëshqasin** mbi akull.

### Bisedojmë!

Ç'rol kanë fjalët e shtypura me shkronja me ngjyra në fjalitë e mësipërme?

Cilit lloji të fjalëve u përkasin kallëzuesit në fjalitë e mësipërme?

Çka shprehin këta kallëzues: **veprim**, **gjendje** a **cilësi**?

### Detyra

#### 1. Lexo fjalitë dhe nënvizo me dy vija kallëzuesin!

Teuta **është** motra ime.

Bora mbuloi tokën shpejt.

Rina luan në piano.

Zogu fluturoi i trembur.

Fëmijët **janë** në dhomë.

Ajo di të këndojë bukur.

Atë ditë ti nuk erdhe!

Unë kam trotinet.

#### 2. Shiko me kujdes ilustrimin dhe sajo një tekst me pesë fjali duke nënvizuar kallëzuesin.



#### 3. Përsërisim!

##### Plotëso fjalitë në vijim.

Pjesët kryesore të fjalisë janë \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

Në fjali kryefjala tregon \_\_\_\_\_, kurse kallëzuesi \_\_\_\_\_.

Kryefjala më së shpeshti shprehet me \_\_\_\_\_, ndërsa kallëzuesi me \_\_\_\_\_.

#### 4. Sajo shtatë fjali duke nënvizuar **me të kuqe** kryefjalën dhe **me të kaltër** kallëzuesin!

## RRETHANORI

### Lexojmë fjalitë:

Vesa e Drita shkuan **në det**.  
Ata erdhën **herët**.  
Petriti erdhi **papritur**.  
Sa **shumë** më mori malli për ty.  
**Nga uria** nuk mund të ecja.  
Lumi ecte **rrëmbyeshëm**.

Fjalët e ngjyrosura me të kuqe: **në det, herët, papritur, shumë, nga uria, rrëmbyeshëm** quhen **rrethanorë**.

### Mbani në mend!

**Rrethanori** është ajo gjymtyrë e fjalisë, e cila tregon rrethanat e kryerjes së një veprimi. Këto rrethana lidhen me kohën, vendin, mënyrën, sasinë, shkakun etj. Rrethanori në fjali e gjejmë me pyetjet: **kur?, ku?, nga?, si?, sa?, përse?** etj. Rrethanorët, pra, tregojnë **vend, kohë, sasi, mënyrë**.

### Detyrë

Lexoni tekstin dhe ngjyrosni me të kuqe rrethanorin!

Shtëpia ime gjendet **pranë** aeroportit. Dimër e verë nga dritarja ime kam dëshirë të shikoj ngritjen e uljen e aeroplanëve. Shpesh në fushën e aeroportit ka shumë aeroplanë. Ndonjëherë afrohem te rrethoja e aeroportit, por kur shoh lart në qiell si po zbret aeroplani unë ngutem e hyj në shtëpi. Nuk e di nëse zhurma e motorit apo vetë ulja e aeroplanit në tokë më frikojnë më tepër. Megjithatë, unë kënaqem kur shikoj nga dritarja e dhomës ime.



**Mbani në mend!**

**Rrethanori mund të hiqet nga fjalia pa u prishur kuptimi i saj.**

### **Detyra**

**1. Nënvizoni në fjalët vijuese rrethanorin, pastaj hiqje dhe shiko si tingëllojnë fjalitë tani. A janë të pakuptimta?**

1. Genci nuk shkon me dëshirë te dentisti.
2. Ajo e kishte fshehur kukullën në dollap.
3. Babai erdhi herët në mëngjes.
4. Unë mësova shpejt vjershën
5. Sivjet do të shkojmë në bjeshkë.

**2. Plotëso fjalitë me ata rrethanorë: në qiell, dje, pak, qartë, për pushim, nga shiu.**

1. Shqiponja fluturoi lart \_\_\_\_\_.
2. Bujari foli \_\_\_\_\_ për ekspozitën.
3. \_\_\_\_\_ bleva sajën për vajzën.
4. \_\_\_\_\_ u ftoh edhe moti.
5. Autobusi u vonua \_\_\_\_\_.
6. Ata shkuan në det \_\_\_\_\_.

**Mbani në mend!**

Sipas rrethanës që tregojnë mund të dallojmë:

1. **rrethanorë vendi** (tregojnë vend)
2. **rrethanorë kohe** (tregojnë kohë)
3. **rrethanorë sasi** (tregojnë sasi)
4. **rrethanorë mënyre** (tregojnë mënyrë)

### Plotësoni zbrazëtitë me ndajfolje sipas shembullit të parë!

Rrethanorë vendi: **mbi tokë**, \_\_\_\_\_.

Rrethanorë kohe: **sivjet**, \_\_\_\_\_.

Rrethanorë sasi: **shumë herë**, \_\_\_\_\_.

Rrethanorë mënyre: **papritur**, \_\_\_\_\_.

### Detyra

#### 1. Vendos në vendet e zbrazëta rrethanorë vendi ose kohe, sipas nevojës!

Vali **dje** fitoi garën.

\_\_\_\_\_ erdhi gjyshja nga Kosova

Babi \_\_\_\_\_ na qorton kur bëjmë zhurmë.

Beni \_\_\_\_\_ ushqente qenin.


\_\_\_\_\_ u duk ylberi shumëgjyresh.

Valët e detit arritën \_\_\_\_\_

Harrova se kisha vendosur çelësin \_\_\_\_\_

Dita e mirë shihet \_\_\_\_\_

#### 2. Thur pesë fjali me rrethanorë vendi ose kohe duke shikuar ilustrimet!



#### 3. Në fjalitë në vijim gjej dhe nënvizo rrethanorët e mënyrës duke përdorur pyetjet brenda kllapave!

Ari u vonua **shumë**. (**Sa?**)

Ai është i gjatë gati dy metra. (**Sa?**)

Blerta është ftohur pak. (**Sa?**)

Ne det qëndruam gjithë verën. (**Sa?**)

Kjo enë zë një litër e gjysmë. (**Sa?**)

Ai është gjaknxehtë. (**Si?**)

Prindërit shkuan në Tiranë me veturë. (**Si?**)

Ata ecnin pa folur. (**Si?**)

Ti i ke flokët e butë si fije mëndafshi. (**Si?**)

4. Lidh me shigjetë fjalitë me rrethanorët përkatës!

Lira ka zakon të flasë **me zë**.

Gjyshi erdhi	para dy ditëve
Çmimi erdhi	tetë muaj
Ajo e përkëdheli	pas një ore
Dita u errësua	shpejt
Bora ia filloi të binte	befasueshëm
Leka u nis	me butësi
Foshnja e saj sot mbush	qetë

5. Plotëso në vendet e zbrazëta me rrethanorë mënyre ose sasi, sipas nevojës!

Ajo hyri në klasë **me rrëmbim**.

Lira u soll me të tepër \_\_\_\_\_

Unë kam lindur \_\_\_\_\_ para vëllait tim.

Tezja vjen gjithmonë \_\_\_\_\_.

Kjo akullore më pëlqen \_\_\_\_\_.

Mësimi na fillon \_\_\_\_\_

6. Thur pesë fjali me rrethanorë mënyre ose sasi duke shikuar ilustrimet!



7. Rrethanorë ka edhe në gjuhën e vendit ku ti jeton. Shkruaj disa!

---

---


---

---



## NJOHURI PËR GJUHËN SHQIPE

### Bisedë me mësuesin e gjuhës shqipe



Ari e Rina janë shumë kureshtarë për të mësuar diçka më tepër për historinë e gjuhës së tyre amtare.

Mësuesja u tregua e gatshme t'u përgjigjet pyetjeve të tyre.

- Kush janë stërgjyshërit e shqiptarëve? – pyeti Ari mësuesen.

- Ilirët, sipas disa dëshmive gjuhësore e arkeologjike, mendohet se janë paraardhësit e shqiptarëve, - u përgjigj mësuesja. Pra, shqiptarët janë bijtë e ilirëve.

- Po kush ishin ilirët? – pyeti me padurim Rina.

- Ilirët ishin një popullsi e madhe në lashtësi që jetonin në Ballkanin Perëndimor. Mendohet se ishin pasardhës të pellazgëve. Ilirët përbëheshin prej fiseve ndër të cilët më së shumti përmenden **liburnët, dalmatët, molosët, labeatët, dardanët, taulantët** etj. – u përgjigj mësuesja.



Harta e fiseve ilire

- Aha, tash po e kuptoj pse shoku im quhet Ilir, ndërsa motra e tij Dardane, – tha Ari.

- Ndërsa vëllai im quhet Labeat, - tha Rina.

- Janë emra të bukur, - tha mësuesja.

- Ku jetojnë shqiptarët sot, - vazhdoi me pyetje Rina.

Shqiptarët jetojnë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbinë Juglindore, Greqinë Veriore dhe në diasporë.



## Shqipja - gjuhë indoevropiane

Gjuha shqipe i përket familjes së gjuhëve indoevropiane dhe përbën **një degë më vete** në këtë familje. Ajo nuk ka lidhje birërie me asnjërën prej gjuhëve të sotme indoevropiane.

Çka ka trashëguar ajo nga gjuhët indoevropiane?

Nga gjuhët indoevropiane shqipja ka trashëguar strukturën e ndërtimit dhe rreth dy mijë fjalë. Këto fjalë janë të përbashkëta me të gjitha gjuhët e tjera indoevropiane, pra edhe me gjuhën franceze, angleze, italiane, suedeze, greke, kroate, daneze e me shumë gjuhë të tjera.

Disa nga fjalët e trashëguara nga gjuha indoevropiane janë: *ditë, natë, diell, kokë, dimër, ujë, ha, pi, jam, zog* etj.


### Shpjegime

gjuhë indoevropiane – gjuhë që i përket grupit a familjes së gjuhëve a dialekteve me prejardhje të përbashkët, të cilat fliten sot në pjesën më të madhe të botës, si në Evropë, Azinë Jugperendimore, Azinë Qendrore dhe në Azinë Jugore.

dëshmi gjuhësorë – të dhëna gjuhësore (fjalë, fjali, të shkruara në letra a në libra të moçëm, etj.), gjetje që flasin për diçka

dëshmi arkeologjike - të dhëna materiale (gjësende, objekte etj.), gjetje që flasin për historinë e lashtë

birëri – të qenët bijë ose bir i dikujt



**Druri gjenealogjik i gjuhëve indoevropiane**

## **Dokumentet e para shkrimore të gjuhës shqipe**

**Çdo gjuhë ka historinë e saj shkrimore.**

Ari e Rina vazhdojnë të interesohen për historinë e gjuhës shqipe. Në orën e gjuhës shqipe ata vazhduan ta pyesnin mësuesen.

- Kur ka filluar të shkruhet gjuha shqipe, - pyeti me kureshtje Ari.

- Gjuha shqipe, edhe pse njëra nga gjuhët më të lashta të Ballkanit, është dokumentuar me shkrim mjaft vonë, në shekullin XV, ndërsa libri i parë në shekullin XVI, – u përgjigj mësuesja e gjuhës shqipe.

### **Mbani në mend!**

Dokumentet e para të gjuhës shqipe janë «Formula e Pagëzimit» (1462), Fjalorthi i Arnold Von Harfit (1496) dhe «Perikopeja e Ungjillit» (shek.XV).

Libri i parë në gjuhën shqipe është «Meshari» i Gjon Buzukut (1555).



Faqe të «Mesharit» të Gjon Buzukut

A është shkruar gjuha shqipe para këtyre dokumenteve?, - pyeti Rina.

Ka shumë të dhëna që na tregojnë se edhe para këtyre shkrimeve është shkruar në gjuhën shqipe, por ende nuk janë gjetur dëshmi. – u përgjigj mësuesja.

### Shpjegime

dëshmi – provë, fakt

perikope – pjesë e një lutjeje fetare në ditët e festave

ungjill – libër fetar i krishterë

meshar – libër i lutjeve i fesë së krishterë

dokument – letër zyrtare që vërteton diçka

dokumentohet – vërtetohet me të dhëna a prova të tjera

### Mbani në mend!

Shkrimtarë të vjetër të gjuhës shqipe janë edhe **Lekë Matrënga, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani dhe Frang Bardhi.**

Fjalori i parë gjuhës shqipe është **Fjalori i Frang Bardhit** i vitit 1635.

### A e dini se:

**Marin Barleti është historiani i parë shqiptar që ka shkruar “Historinë e jetës dhe veprës së Skënderbeut” (1508-1510). Kjo vepër është shkruar në gjuhën latine.**

### Dialektet e gjuhës shqipe

Në orën e re të gjuhës shqipe Ari e pyeti mësuesen:

- A flasin të gjithë shqiptarët njësoj?
- Të gjithë shqiptarët flasin shqip, por me dallime të vogla, sepse vijnë prej krahinave të ndryshme shqiptare. Edhe gjuha shqipe, sikur gjuhët e tjera, ka dialekte e të folme.
- Ç’është dialekti e ç’është e folmja? - pyeti me shumë interesim Rina.
- Dialekti është variant a lloj i gjuhës që flitet nga një bashkësi a nga një grup njerëzish që banojnë në një territor më të gjerë a më të kufizuar, ndërsa e folmja është variant gjuhësor që flitet në një territor shumë më të ngushtë, është ndarje nëndialektore, sikur fjala vjen e folmja e Prizrenit, të folmet e arbëreshëve etj.

### Mbani në mend!

#### Gjuha shqipe ka dy dialekte:

- dialektin e Veriut ose **gegërishten** që flitet në Shqipërinë e Veriut, në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore, në Serbinë Juglindore dhe në Malin e Zi, dhe

- dialektin e Jugut ose **toskërishten** që flitet në Shqipërinë e Jugut, në Çamëri e në diasporën shqiptare në Itali, Greqi, Bullgari e Ukrainë.

Dy dialektet e shqipes i ndan lumi Shkumbin. Ato kanë disa nëndialekte e shumë të folme.

- Çfarë janë dallimet midis dialekteve të gjuhës shqipe? - pyeti Ari.
- Dallimet midis dialekteve të shqipes nuk janë të mëdha. Shqiptarët kudo janë kuptohen pa vështirësi njëri me tjetrin, - tha mësuesja.
- Cilat janë dallime? – pyeti me kureshtje Rina?
- Ekzistojnë disa dallime në sistemin fonetik dhe në strukturën gramatikore e shumë më pak në leksik.

**Dallimet kryesore janë këto:**

- në fonetikë dialekti i Veriut, gegërishtja, ka zanore hundore: **nâna, kânga, âmbël, âsht, râna, ândrra, zâni**, kurse në dialektin e Jugut këto zanore na dalin me **ë**: nëna, kënga, ëmbël, është, rëra, ëndrra, zëri.

- në gegërishte, togu **ua** i toskërishtes del me **ue**:

<b>grua</b>	<b>grue</b>
<b>përrua</b>	<b>prrue</b>
<b>thuj</b>	<b>thuej</b>
<b>mua</b>	<b>mue</b>

-në toskërishte fjalët me **-n-** midis dy zanoreve dalin me **-r-**:

<b>bëra</b>	<b>bana</b>
<b>dimër</b>	<b>dimën</b>
<b>lakra</b>	<b>lakna</b>
<b>hyri</b>	<b>hyni</b>
<b>fëmijëri</b>	<b>fëmijëni</b>

-në morfologji vërejmë dallimin e shumësit të emrave:

<b>nxënës</b>	<b>nxânësa</b>
<b>puse</b>	<b>pusa</b>
<b>mollë</b>	<b>molla</b>
<b>brirë</b>	<b>brina</b>
<b>shtëpi</b>	<b>shtëpija</b>

-në leksik (d.m.th. në fjalët) dallimet janë më të vogla. Mbi 90% e leksikut të shqipes janë të përbashkët për të dyja dialektet. Disa fjalë përdoren vetëm në gegërishten ose vetëm në toskërishten:

<b>krye</b>	<b>kokë</b>
<b>katund</b>	<b>fshat</b>
<b>tambël</b>	<b>qumësht</b>
<b>tlyn</b>	<b>gjalpë</b>
<b>çikë</b>	<b>vajzë</b>

## Lexo me kujdes poezitë e mëposhtme!

### Gjej dallimet e ngjashmëritë gjuhësore në to!

#### Toskërisht

##### Gjuha jonë

Vëllezër shqipëtarë!  
Të prekim urtësinë  
Të zëm'udhën e mbarë,  
Të ngjallim Shqipërinë  
.....  
Të shkruajm' gjuhën tënë,  
Kombinë ta ndritojmë,  
Gjithë ç'është e ç'ka qënë,  
Ngadalëzë ta msojmë.  
Naim Frashëri

##### Mbani në mend!

Naim Frashëri është njëri prej shkrimtarëve më të mëdhenj shqiptarë. Ka jetuar në shek. XIX. Veprat e tij kryesore janë: *Lulet e Verësë* dhe *Bagëti e Bujqësija*.



#### Gegërisht

##### Gjuha shqype

Porsi kanga e zogut t'verës,  
qi vallzon n'blerim të prillit;  
porsi i ambli flladi i erës,  
qi lmon gjit e drandofillit;  
porsi vala e bregut t'detit,  
porsi gjâma e rrfës zhgjetare,  
porsi ushtima e një tërmetit,  
ngjashtu â'gjuha e jonë shqyptare.

##### Mbani në mend!

Gjergj Fishta është njëri prej shkrimtarëve më të mëdhenj shqiptarë. Ka jetuar në fund të shek XIX dhe në pjesën e parë të shek.XX. Veprat e tij kryesore janë: *Lahuta e Malcis* dhe *Anzat e Parnasit*.



#### Bisedojmë!

- Çka keni vërejtur gjatë leximit?
- Cilat janë dallimet që keni vërejtur?
- A i keni kuptuar tekstet që i lexuat?
- A ju duken të mëdha dallimet gjuhësore midis këtyre dy poezive?
- A kanë edhe gjuhët e tjera dialekte?

## Gjuha standarde shqipe

Para vitit 1972 të gjithë shkrimtarët kanë shkruar në dialektin e vet. Në vitin 1972 në Tiranë u mbledhën studiuesit e gjuhës shqipe dhe mbajtën Kongresin e Drejtshkrimit. Në Kongres u miratuan rregullat e drejtshkrimit. Që nga ajo kohë shqiptarët kanë një gjuhë të përbashkët shqipe.

### Mbani në mend!

Gjuha standarde nuk është gjuhë dialektore. Ajo është gjuha jonë e përbashkët, gjuha e shkollës, gjuha e televizionit dhe gjuha e dokumenteve zyrtare.

Në orën e mësimit Ari e pyeti mësuesen:

- Po ne në cilin dialekt flasim e shkruajmë në shkollën shqipe?
- Në shkollë, ne flasim, shkruajmë e mësojmë në gjuhën standarde. Edhe në televizor dëgjojmë të flitet në gjuhën standarde. Edhe librat, gazetat e revistat që lexojmë janë në gjuhën standarde. – u përgjigj mësuesja.
- Po në shtëpi si flasim? – pyeti Rina.
- Që nga lindja secili nga ju keni mësuar të flisni si flet nëna, babai dhe anëtarët e tjerë të familjes suaj, domethënë keni mësuar të flisni në dialektin a të folmen tuaj - dikush në gegërishte, dikush në toskërishte. Kur fillojmë shkollën takohemi me gjuhën shqipe pak a shumë më e ndryshme se gjuha që kemi mësuar në familje – ajo është gjuha letrare ose gjuha standarde shqipe. Ajo është krijuar me marrëveshje mbi bazën e dialektit toskë, por përmban edhe shume elemente të gegërishtes.

### Duhet ta dini se:

Gjuha standarde duhet të mësohet, sepse ajo është gjuha jonë e përbashkët dhe gjuha në të cilën shkruajmë. Të mësohet gjuha letrare nuk është bash lehtë. Gjuhën standarde e mësojmë në shkollë, ndërsa për ta mësuar na ndihmojnë edhe gramatika, drejtshkrimi dhe fjalori.

### Mbani në mend!

Nuk është e thënë t'i dimë të gjitha pyetjet që lidhen me gjuhën standarde. E rëndësishme është të dimë ku t'i gjejmë përgjigjet. Për këtë na ndihmojnë Fjalori.

**Drejtshkrimi dhe Gramatika** Fjalori është libër në të cilin janë shkruar e shpjeguar një numër i madh i fjalëve të gjuhës shqipe. Pos fjalëve, ai përmban edhe shprehje të ndryshme në të cilat paraqiten fjalë të caktuara.

**Drejtshkrimi** është libër që na mëson si të shkruajmë drejt. Ai përmban rregullat e drejtshkrimit, fjala vjen, si t'i shkruajmë tingujt e caktuar, kur shkruajmë shkronjën e madhe, si t'i shkruajmë fjalët e huaja, si t'i përdorim shenjat e pikësimit etj.

**Gramatika** është vepër ku përshkruhet sistemi i gjuhës dhe ligjet e këtij sistemi. Aty gjejmë gjithçka për tingujt dhe ndarjen e tyre, llojet e fjalëve, fjalinë e pjesët përbërëse të saj, llojet e fjalive etj.



Shefkije Islamaj, Nexhmije Thaçi–Mehmetaj  
**GJUHA SHQIPE**  
**Fletore tematike - për nivelin e dytë**

Botimi i parë

Botues:

*Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë*

Për botuesin:

*Agim Lluka*

Redaktor teknik:

*Lavdim Beqiri*

Tirazhi: 5.000 *kopje*

*Formati: 205x285*

U shtyp në prill 2012

në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë

[www.dukagjinigroup.com](http://www.dukagjinigroup.com)

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

811.18:37(076.1)

Islamaj, Shefkije

Gjuha shqipe: fletore tematike për nivelin e dytë /

Shefkije Islamaj, Nexhmije Thaçi - Mehmetaj. - Botimi i parë.

- Dukagjini, 2012. - 64 f.: ilustr. me ngjyra; 28 cm.

1. Thaçi - Mehmetaj, Nexhmije

**ISBN 978-9951-05-248-1**

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,*

*të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 813-304, të datës 14.02.2012*